



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 89 , datë 15.11.2018**

**PËR**

**“SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.78, DATË 01.10.2018 TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP  
“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT: “ANALIZË E TREGUT CELULAR: TREGU ME SHUMICË  
I AKSESIT DHE ORIGJINIMIT; TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE  
NDËRKOMBËTARE DHE TREGU ME PAKICË I SHËRBIMEVE CELULARE – DOKUMENT  
PËRFUNDIMTAR”,  
DHE SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT DREJTUES  
PËRKATËSISHT NR.79, NR.80, NR.81 DHE NR.82, DATË 01.10.2018.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 15/11/2018, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shfuqizimin e Vendimit Nr.78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar” dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr. nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP.

**BAZA LIGJORE:**

1. Pikën 1, neni 37, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (**ligji 9918/2008**);
2. Neni 113 e vijues, i Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, (**ligji 44/2015**);
3. Rregullore Nr.9, “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar (**Rregullore nr.9**);
4. Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (**Rregullore nr.7**)

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projekt vendimit të përgatitur nga Kryetari i Këshillit Drejtues (*Relacioni*);
2. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar.

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Në përfundim të procedurave të këshillimit publik të zhvilluar në periudhën kohore 26.02.2018 – 28.04.2018, AKEP pas marrjes së komenteve dhe qëndrimeve të palëve të interesuara, me Vendimin Nr.78 datë 01.10.2018 miratoi dokumentin *“Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”*. Ky vendim shërben si bazë për marrjen e vendimeve për sipërmarrësit me FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive.
2. Referuar këtij vendimi AKEP ka miratuar vendimet për sipërmarrësit e shpallur me FNT, përkatësisht VKD nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018 si më poshtë vijon.
3. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.79, datë 01.10.2018, ka përcaktuar sipërmarrësin “Vodafone Albania Sh.a” me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare, duke caktuar dhe masat përkatëse rregullatore.
4. Me Vendimin Nr.80 të Këshillit Drejtues të AKEP, datë 01.10.2018, ka përcaktuar sipërmarrësin “Albtelecom Sh.a” me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, si dhe masat përkatëse rregullatore.
5. Me Vendimin Nr.81 të Këshillit Drejtues të AKEP, datë 01.10.2018, ka përcaktuar sipërmarrësin “Telekom Albania Sh.a” me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, si dhe masat përkatëse rregullatore.
6. Me Vendimin Nr.82 të Këshillit Drejtues të AKEP, datë 01.10.2018, ka miratuar për këshillim publik dokumentin: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare”*.
7. Në vijim të një procedure të shpeshtë administrative shkresore me pretendime dhe ankesa të paraqitura nga sipërmarrësit “Vodafone Albania Sh.a”, “Neofone” dhe “Albtelekom Sh.a”, është kërkuar në vazhdimësi që AKEP:
  - a) të ndërmarrë procedurat administrative për rishikimin/anullimin/shfuqizimin e masave rregulluese,
  - b) të shfuqizojë Dokumentin e analizës për tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare.
8. AKEP:
  - a) në përputhshmëri dhe në zbatim të parimeve të Drejtësisë, Paanësisë, Objektivitetit, Proporcionalitetit dhe të Përgjegjësisë, të shprehura qartësisht në Kodin e Procedurave Administrative (*ligji 44/2015*);
  - b) duke konsideruar sektorin e telekomunikacioneve si një nga sektorët strategjikë të vendit;
  - c) duke vlerësuar zhvillimet dhe investimet e rëndësishme në këtë sektor;

- d) duke u kujdesur maksimalisht për të garantuar një klimë mirëkuptimi dhe mbështetëse për investimet e operatorëve të këtij tregu;
- e) dhe duke vlerësuar seriozisht asistencën e ofruar nga strukturat e Komisionit Evropian që kanë shprehur mbështjen e tyre të plotë dhe gadishmërinë për të kontribuar me ekspertizë të kualifikuar në procesin shumëdimensional të analizave të tregjeve;

vlerëson *suo motu*, të domosdoshme të vijojë me procedurën administrative për shfuqizimin e aktit administrativ Vendim Nr.78, datë 01.10.2018, “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar” si dhe shfuqizimin e Vendimeve të tjera sic citohen në këtë Vendim.

9. Arsyetimet sa më sipër, mbështeten edhe në parashikimet e ligjit dhe konkretisht në përcaktimet ligjore të nenit 113, pika 1: “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”, të Kodit të Procedurave Administrative (ligji 44/2015), i cili parashikon shprehimisht se: “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj”.

10. Marrja e këtij Vendimi për shfuqizimin e aktit/akteve administrative të sipërcituara:

- a) Është në përputhje edhe me parimin e diskrecionit të organit publik për të ushtruar në mënyrë të ligjshme vullnetin e tij dhe në kushtet e vlerësimit të veçantë të kriterëve/parimeve të objektivitetit, drejtësisë, përgjegjësisë administrative dhe të proporcionalitetit.
- b) Është në përputhje edhe me dispozitat e parashikuara në Kreun VI, “Rregullimi i Konkurrencës”, referuar të Ligjit nr.9918/2008.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, nenin 113 e vijues të Ligjit Nr. 44/2015, Këshilli Drejtues i AKEP,

#### **V E N D O S I:**

1. Shfuqizimin e VKD nr.78, datë 01.10.2018, “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”.
2. Shfuqizimin e VKD Nr.79, datë 01.10.2018 “Për përcaktimin e sipërmarrësit “Vodafone Albania sh.a” me Fuqi të Ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore”.
3. Shfuqizimin e VKD Nr.80, datë 01.10.2018, “Për përcaktimin e sipërmarrësit “Albtelecom sh.a” me Fuqi të Ndjeshme në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore”.
4. Shfuqizimin e VKD Nr.81, datë 01.10.2018, “Për përcaktimin e sipërmarrësit “Telekom Albania sh.a” me Fuqi të Ndjeshme në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore”.
5. Shfuqizimin e VKD Nr.82, datë 01.10.2018, “Për miratimin në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në tregjet me shumicë të aksesit dhe origjinimit i shërbimeve celulare”.
6. Nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse referuar sa më lart, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri të plotë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

7. AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfituar ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces.
8. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare online të AKEP, sipas procedurës së parashikuar në nenin 118, të Ligjit Nr.9918/2008, i ndryshuar.
9. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Ilir ZELA**

**Klarina ALLUSHI**

**Ketrin TOPÇIU**

**Edlira DVORANI**